



BIRN është në kërkim të kolegëve të rinj/reja për pozitën:

Dy Zyrtarë/e për Financa

Për të aplikuar dhe për të përmbushur pozitën, duhet të keni:

- kualifikim përkatës/titull të avancuar në financa ose fushë të ngjashme ekuivalente;
- të paktën 3 vite përvojë të mëhershme në kontabilitet;
- njohje të legjislacionit dhe rregullave financiare të OJQ-ve;
- aftësi të mira ndër-personale dhe aftësi për punë ekipore;
- gatishmëri për të punuar me orar të plotë dhe fleksibil;
- aftësi të komunikimit verbal dhe me shkrim në gjuhën amtare dhe angleze;
- aftësi të raportimit të cilësisë së lartë.

Përparësi do të kenë kandidatët me:

Përvojë paraprake në Organizata Jo Qeveritare ose me donatorë;

Kandidatët e certifikuar me kualifikime përkatëse në financa/kontabilitet (prej agjencie ekuivalente me Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës).

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Do të jenë përgjegjës për administrim dhe raportim financiar në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe të nevojshme, sipas politikave kontabël dhe udhëzimeve financiare, duke asistuar në:

- përgatitjen dhe regjistrimin e librave me të dhënat e nevojshme;
- regjistrimin e transaksioneve në softuerin për financa;
- rakordimin e llogarive të bilancit të gjendjes në baza mujore;
- përgatitjen e kërkesave financiare dhe pagesave të ndryshme, sipas kërkesës;
- përgatitjen e buxheteve dhe dhënien e shpjegimeve të ndryshimeve në raportet financiare të projekteve;

- përgatitjen e raporteve në mënyrë periodike;
- përgatitjen e pasqyrave financiare sipas politikave/procedurave Kontabël dhe standardeve të kontabilitetit të Kosovës;
- përgatitjen/deklarimin e raporteve vjetore siç kërkohet nga Zyra Tatimore e Kosovës;
- të punojë ngushtë me stafin menaxhues lidhur me proceset e auditimit të jashtëm dhe të brendshëm, dhe aktivitete të ndryshme financiare.

Për të aplikuar, duhet të dërgoni **Curriculum Vitae (CV) dhe një letër motivimi në gjuhën amtare dhe angleze, bashkë me dokumentet shtesë përcjellëse**, përmes postës elektronike në adresën **rekrutimi@jetanekosove.com** më së largu deri më **15 nëntor 2018**.

BIRN inkurajon aplikuesit nga të dy gjinitë, si dhe ofron mundësi të barabartë punësimi për të gjithë personat e interesuar, pa kurrfarë paragjykimi mbi baza gjinore, fetare, etnike ose politike.

Informata shtesë për BIRN Kosova mund të gjeni në www.birn.eu.com